

Riza (Halit) Haliti

(9.01.1980, shqiptar nga Vojniku/Voćnjak, komuna e Skënderajt/Srbica, nxënës, pjesëtar i UÇK-së)

Riza aderoi në UÇK në muajin nëntor të vitit 1997. Ishte vetëm 17 vjeç. Ka qenë në përbërje të njësitit lokal në fshatin e tij të lindjes së **Turiqecit/Turićevac**, nën komandën e Abedin Rexhes. Në datën **10.11.1998**, Riza me bashkëluftëtarët gjendeshin në pozicionin në afërsi të shkollës filllore, përderisa forcat serbe ishin në *Mëhallën Kastrati* në fshatin fqinj të Burojës/Broćna. Kohë pas kohe, e shkëmbenin zjarrin mes vete. Për një çast, Riza u nis drejt shkollës për ta vëzhguar terrenin. Përderisa i afrohej shkollës, e qëlluan për vdekje në kokë. E kanë varrosur një ditë më vonë në varrezat e Vojnikut/Voćnjak, ku prehet edhe sot.

Burimet: deklarata H.A, FDH-32476; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092.

Brahim (Hajrë) Musliu

(10.07.1944, shqiptar nga Klina e Poshtme/Donja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, i pamartuar)

Në datën **5.12.1998**, rreth orës 10:00, Brahim me dy djemtë e të vëllait, u nis me qerre me një kalë samari në pyll për të ngarkuar dru. Ushtria serbe ishte e pozicionuar në *Mëhallën e Baranëve [Klinë e Poshtme/Donja Klina]*. Kur Brahim me dy djelmosha arritën te vendi i quajtur *Te Kodra e Kalit/Konjski breg*, ushtarët serb shtënë ndaj tyre. Së pari e qëlluan kalin në shpinë, ndërkaq, më pas, edhe Brahimin. Djelmoshat arritën që të shpëtonin nga plumbat. Pas gjysmë ore, ata u kthyen dhe e gjetën trupin e pajetë të Brahimit, i cili ishte i shtrirë mbi qerren. Po atë ditë, vëllai i Brahimit ka shkuar në pyll dhe i ka sjell kalin dhe qerren me trupin e Brahimit. Vëzhguesit e misionit të OSBE-së e kanë kryer hetimin në vendngjarje. Familjarët e kanë varrosur Brahimin në mbrëmje në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata S.M, FDH-13665; *Serb Snipers Kill Albanian in Drenica, Shoot Others in Malisheva*, pasqyra e lajmeve, KIC, 07.12.1998, FDH-30759.

Agim (Sadri) Osaj

(13.07.1957, shqiptar nga Klina e Epërme/Gornja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, tre fëmijë)

Hakë (Sadri) Osaj

(1.03.1976, shqiptare nga Klina e Epërme/Gornja Klina, komuna e Skënderajt/Srbica, amvise)

Hakë Osaj jetonte me prindërit, vëllezërit Agimin dhe Qamilin, familjet e tyre dhe motrën Afërditën. Pas vrasjes së anëtarëve të familjes Jashari, policia e ka vendosur një postbllok në rrugë, pranë shtëpisë së tyre [**Klinë e Epërme/Gornja Klina**]. Në mbrëmje, më **23.12.1998**, e gjithë familja gjendej në dhomën e pritjes së shtëpisë [përpos Qamilit, i cili ishte në UÇK]. Për një vizite në familje ndodheshin motra e martuar Zoja dhe një fqinje. Nga ora 21:00, ata vërejtën që dikush gjendej te dritarja e shtëpisë. Nëna Qerime doli në derë, ndërsa pas saj dolën edhe tjerë. I vërejtën tre burra të maskuar me uniforma të ngjyrës së gjelbër. Qerimja i pyeti se kush ishin dhe çfarë po kërkonin. Atëherë, një nga ta e hodhi bombën e dorës në korridorin e shtëpisë. Ciflat e saj e kanë plagosur Hakën dhe Agimin. Ajo ishte e lënduar në kokë dhe në gjoks dhe gati menjëherë ndërroi jetë. Agimin e quan në spitalin e Prishtinës/Priştina, por atje nuk deshën që ta pranonin për kurim. Familjarët kishin drojë ta lirin Agimin në spitalin e Skënderajt/Srbica, sepse atje kishte shumë policë. Gjendja e tij vështirësohej dita ditës. Ka dhënë shpirt më 19.05.1999 në pyllin e fshatit fqinj të Kuqices/Kučica, ku familja e tij ishte strehuar. E kanë varrosur në pyll po atë ditë. Pas lufte, më 28.06.2005, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Agimit në Klinën e Epërme/Gorna Klina.

Burimet: deklarata F.O, FDH-36609; *One Albanian Killed, Eight Wounded by Masked People in Klina e Eperme Villages*, pasqyra e lajmeve, KIC, 24.12.1998, FDH-30860.
